



VENDIM

Nr. 22 Datë 10.03.2011

PËR

**PRANIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT TË
ERE-S NR.10, DATË 18.02.2011**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.03.2011, mbasi shqyrtoi shkresat e paraqitura nga shoqëritë CEZ Shpërndarje sh.a dhe KESH sh.mbi kthimin e shoqersë “Albanian Chrome” sh.p.k, për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e Klientit Tarifor,

Konstatohet se :

- CEZ Shpërndarje sh.a konfirmon se është i gatshëm t'i ofrojë shërbimin e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike shoqërisë ACR sh.p.k, duke filluar nga 15 Mars 2011, por pa përmendur kostot që mbart në vetvete ky kthim dhe marrjen përsipër të tyre.
- CEZ Shpërndarje sh.a, pretendon që kostot shtesë që shkaktohen nga furnizimi me energji elektrike të shoqërisë “Albanian Chrome” sh.p.k, të mos i paguajë as CEZ-Shpërndarje sh.a dhe as kompania që përfiton statusin e ri, por ato të axhustohen përmes tairfës së furnizimit publik me shumicë duke e transferuar tek subjektet e tjera pjesëmarrëse në tregun e energjisë, gjë që bie ndesh me Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike (pika 7, gërma “a”) dhe Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë (pika IV.2).
- KESH sh.a, me shkresën nr. 1289 Prot., datë 08.03.2011 rideklaron se kthimi i Klientit të Kualifikuar “Albanian Chrome” sh.p.k, në Klient Tarifor sjell pashmangshmërisht rritjen e kërkesës së CEZ Shpërndarje sh.a dhe detyrimisht kosto shtesë për KESH sh.a. KESH-i, kërkon nga ERE, që në rast kthimi të “Albanian Chrome” sh.p.k, në Klient Tarifor, kostot shtesë të ngarkohen këtyre subjekteve në bazë të Modelit dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

- Përfaqësuesit ligjor të shoqërisë ACR sh.p.k shprehen dakort me përmbajtjen e relacionit të paraqitur në mbledhjen e Bordit të Komisionerëve dhe kërkuan të jetë në diskrecionin e tyre për të vendosur nëse do ta ushtrojnë të drejtën për tu kthyer në statusin e Klientit Tarifor ose jo.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Subjekti “Albanian Chrome” sh.p.k, lejohet të kthehet nga Klient i Kualifikuar në Klient Tarifor duke filluar nga data 15 Mars 2011, duke mbuluar të gjitha kostot shtesë të shkaktuara ndaj KESH sh.a në funksionin e tij si Furnizues Publik me Shumicë.
2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga CEZ Shpërndarje sh.a tek subjekti “Albanian Chrome” sh.p.k, për periudhën nga bërja efektive e statusit të Klientit Tarifor deri në datën 31 Dhjetor 2011, do të jetë 14.55 lekë/kWh.
3. Me bërjen efektive të statusit të Klientit Tarifor nga ACR sh.p.k, CEZ Shpërndarje sh.a do të paguajë çdo muaj shoqërisë KESH sh.a, diferencën ndërmjet çmimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi dhe tarifës përkatëse të kategorisë së Klientëve Tariforë ku përfshihet “Albanian Chrome” sh.p.k, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.100, datë 07.12.2010, (14.55 lekë/kWh – 7.62 lekë/kWh te barabarte me 6.93 leke per çdo k Wh, te faturuar klientit “Albanian Chrome”).
4. ACR sh.p.k, të vendosë për statusin përfundimtar brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
5. ACR sh.p.k të njoftojë CEZ Shpërndarjen dhe ERE-n 5 ditë para ditës së bërjes efektive të statusit të Klientit Tarifor.
6. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë “Albanian Chrome” sh.p.k, CEZ Shpërndarje sh.a dhe KESH sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 22 Datë 10.03.2011

PËR

**PRANIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT TË
ERE-S NR.10, DATË 18.02.2011**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____